

TË SIGUROHET BALANS NË EMISIONET E VEÇANTA INFORMATIVE

Shkup, 02.07.2020. – Deri te Agjencia për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale dje ariti një ankesë nga Bashkimi Demokratik për Integrim – BDI me të cilën ata reagues lidhur me organizimin e emisioneve debative në programet e medimeve .

Agjencia inspektoi menjëherë të dhënat nga monitorimi i deritanishëm i prezantimit mediatik zgjedhor , duke kujtuar radiodifuzerët dhe pjesëmarrësit në fushatën zgjedhore si më poshtë:

Radiodifuzerët, nëse vendosin të emetojnë debate dhe lloje të tjera të emisioneve informative (përballje, intervista, emisione -aktuale informative, emisione të specializuara, etj.), duhet të sigurojnë qasje dhe drejtësi të barabartë, ekuilibër dhe paanshmëri. Në këto emisione, bilanci arrihet duke respektuar parimin e proporcionalitetit sipas numrit të listave të konfirmuara të kandidatëve, që do të thotë se radiodifuzerët janë të detyruar ti ftojnë të gjithë pjesëmarrësit që kanë të njëjtin numër listash të kandidatëve të konfirmuar, pavarësisht nëse janë parlamentarë apo subjektet jo-parlamentare, dhe pavarësisht nga gjuha në të cilën transmetojnë programin. Format i këtyre emisioneve – përballjet (midis dy) ose debati (midis të më shumë), vendoset nga vetë radiodifuzerët në përputhje me politikën e tyre të pavarur redaktuese.

Vlerësimi nëse këto detyrime janë përmbushur tërhiqet pas përfundimit të fushatës, jo për secilin emision individualisht, por për serinë e intervistave, emisioneve debative ose përballjeve që radiodifuzerët do të organizojë

gjatë fushatës zgjedhore.

Monitorimi i deritanishëm tregon se ka radiodifuzerë që duhet të bëjnë përpjekje shtesë dhe të ftojnë të gjithë subjektet me të njëjtin numër listash për të siguruar një ekuilibër në debate deri në fund të fushatës. Nga ana tjetër, ka raste në të cilat pjesëmarrësit në fushatën zgjedhore nuk pranojnë të marrin pjesë në emisione debative në disa media. Radiodifuzerët duhet ta shpallin këtë në emisionet dhe në të njëjtën kohë, duhet të jenë të kujdesshëm sa herë do të përsërisin debatin për të mos krijuar një dizbalansim.

Në këtë kontekst dhe duke pasur parasysh që këto zgjedhje janë të organizuara në kushte të pandemisë, Agjencia u bën apel pjesëmarrësve në fushatën zgjedhore të marrin pjesë në emisione informative të veçanta sepse ato janë një nga mënyrat që qytetarët të informohen drejtpërdrejt në lidhje me programet e tyre zgjedhore dhe të krahasojnë ofertën.